

Agjencia për Media dhe Informim ju bën me dije vendimet e miratuara në mbledhjen e sotme të qeverisë datë 06.02.2026:

•Këshilli i Ministrave ka miratuar një paketë vendimesh për indeksimin me 2.5% të pagave dhe elementeve përbërëse të tyre në disa kategori të administratës publike për vitin 2026.

(Vendimet përfshijnë rritjen e pagës së Presidentit të Republikës dhe të pagës referuese bazë për funksionet gjyqësore dhe të prokurorisë, si edhe përditësimin e strukturave të pagave për Gardën e Republikës, Policinë e Burgjeve, koordinatori kundër korrupsionit, punonjësit mbështetës dhe specialitetet e ndryshme në administratë, si dhe personelin e sistemit shëndetësor.)

Krahas indeksimit, në disa sektorë parashikohen edhe rregullime specifike të shtesave dhe kompensimeve.

Efektet financiare përballohen nga buxheti i miratuar për vitin 2026 dhe vendimet hyjnë në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare, me efekte financiare nga 1 janari 2026.

Projektligj për dhënie amnistie

Qëllimi i këtij ligji është të përjashtojë nga vuajtja e dënimit dhe ndjekja penale, tërësisht ose pjesërisht, të gjithë personat që plotësojnë kriteret, sipas dispozitave të këtij ligji.

Dhënia e amnistisë, sipas këtij ligji, udhëhiqet nga:

-parimi i humanizmit;

-arritja e qëllimit të dënimit;

-rrezikshmëria e ulët e personave që amnistohen;

-edukimi dhe rehabilitimi;

-mbrojtja e interesit publik;

-dhënia e mundësisë së integritimit më të lehtë dhe më të shpejtë të të dënuarve të mitur dhe gra;

-rritja e eficiencës në sistemin e drejtësisë;

-mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijës.

Në mbledhjen e sotme gjithashtu u miratuan emërimet dhe lirimet e disa funksionarëve:

Z. Dashnor Sula emërohet inspektor i Përgjithshëm i Inspektoratit të Përgjithshëm.

Z. Afrim Qendro, prefekt i Qarkut të Tiranës, lirohet nga kjo detyrë.

Z. Shkëlqim Hajdari emërohet prefekt i Qarkut të Tiranës.